



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.975/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Milena Gjeriq e Valon Totaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike të paditësit A.K. nga fshati, Komuna e Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson A.H. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit B.R. nga fshati, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson R.H. avokat në Prizren, për dorëzimin e paluajtshmërisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe ankesës së të paditurit e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.84/2017 të datës 01.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN ankesa e paditësit A.K. nga fshati, Komuna e Prizreni dhe ankesa e të paditurit B.R. nga fshati, Komuna e Prizrenit, si të pa themelta, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.84/2017 i datës 01.11.2017, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, pjesërisht miratohet kërkesëpadia e paditësit A.K. nga Prizreni. Detyrohet i padituri B.R. t'i dorëzon në posedim dhe shfrytëzim paditësit A.K., sipërfaqen prej 44m² të parcelës kadastrale nr.1833-25 ZK Lubizhdë, në masa dhe kufij: nga ana veriore me thyerje 17.49 m, nga ana lindore 11.03m, nga ana jugore 7.66m dhe nga ana perëndimore 3.63m. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, mbi pjesën e miratuar e që ka të bëjë me dorëzimin edhe të sipërfaqes prej 326m², të parcelës kadastrale nr.1833-18 ZK Lubizhdë dhe sipërfaqes prej 169m², të parcelës kadastrale nr.1833-20 ZK Lubizhdë, refuzohet si e pa bazuar. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak shkeljes esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar edhe i padituri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit me miratimin e ankesës së të paditurit aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj në atë mënyrë që padinë e paditësit ta hedhë poshtë ose ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës kompetente në riprocedim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri të liron nga sendet dhe njerëzit dhe të njëjtin t'ia dorëzoj në posedim të lirë paditësit ngastrat me dimensionet si më poshtë: sa i përket ngastrës 1833/18 të lirohet hapësira prej 326m², me dimensionet nga ana veri lindore 33,69m, nga ana juglindore 16.48m, nga ana jugperëndimore 32.92m, nga ana veriperëndimore 11.03m, sa i përket ngastrës 1833-20 të liron sipërfaqen prej 169m² me këto dimensione: në anën veriore 40.43m, nga ana lindore 3.63m, nga ana jugore 41.76m, ndërsa nga ana perëndimore 5.24m. Sa i përket parcelës. Sa i përket parcelës 1833-25 të liron 44m², me dimensione nga ana veriore 17.43m, nga ana lindore 11.03m, nga ana jugore 7.66m, nga ana perëndimore 3.63m, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Poashtu ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: kontrata e shitblerjes Leg.Nr.1728/2008 e datë 23.03.2008, çertifikata për njësinë kadastrale nr.01833-18 ZK Lubizhdë, aktvendimet mbi bartjen e pronësisë datë 12.07.2007, 23.04.2008 dhe 28.08.2008, lista poseduese për ngastrat kadastrale nr.1833-18 dhe 1833-20 ZK Lubizhdë, kopja e planit nr.413 datë 21.03.2012, kontratat për shitblerjen e paluajtshmërive Leg.nr.3438/2007 datë 18.06.2007, Leg.nr.2565/2008 datë 06.08.2008 dhe Leg.nr.1728/2008 datë 28.03.2008 si dhe raporti i ekspertit të gjeodezisë Dukagjin Berisha datë 24.08.2017.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike: se nga palët nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë pronarë i parcelës kadastrale nr.1833-0 ZK Lubizhd. Kontestuese mes palëve ka qenë fakti nëse pjesa e parcelave nr.1833-18, 1833-20 dhe 1833-25 në të cilat pjesë pala e paditur ka shtruar zhavorr e cila është shfrytëzuar si rrugë pas shtruarjes me zhavorr, mund të kërkohet dorëzimi i asaj pjese nga paditësit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 319.1 i LPK-së: “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e miraton kolegji i Gjykatës së Apelit dhe gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilën gjë kolegji kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji gjithashtu ka gjetur se, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete përse ka vendosur dhe çfarë ka marrë për bazë me rastin e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor. Arsyet e dhëna si në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i pranon në tërësi kolegji i Gjykatës së Apelit. Për këto shkaqe kolegji ka gjetur se është bërë edhe aplikimi i drejtë i të drejtës materiale.

Kolegji gjen se paditësi ka kërkuar që të obligohet i padituri të liron dhe të njëjtat t’ia dorëzoj në posedim të lirë paditësit ngastrat: 1833/18, 1833-20 dhe 1833-25, mirëpo në rastin konkret paditësi është pronar vetëm i parcelës kadastrale nr.1833-25 ZK Lubizhdë, ndërsa ngastrat e tjera evidentohen në emër të pronarëve të tjerë, e për të cilat ngastra paditësi nuk ka ndonjë

autorizim mbi të njëjtat, ngase nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë është vërtetuar se pjesa e rrugës dhe atë në sipërfaqe 44m², si pjesë e ngastrës kadastrale 1833-25 ZK Lubizhdë evidentohet në emër të paditësit A.K.. Në anën tjetër, pretendimet e të paditurit se këtë pjesë të ngastrës e ka në posedim i padituri, dhe dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pa ekzekutueshëm, kolegji i ka refuzuar si të pa bazuara, për faktin se, paditësi ka provuar se mbi sendin që e kërkon e ka të drejtën e pronësisë, ndërsa i padituri nuk ka provuar se këtë paluajtshmëri e mban mbi ndonjë bazë ligjore.

Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Nga të gjitha këto që u parashtruan më lartë, rezulton se, nuk qëndrojnë thëniet ankimore të parashtruara nga ana e palëve ndërgjyqëse, këto thënie kanë mbetur vetëm në nivel të pretendimeve dhe si të tilla edhe janë refuzuar si të pa bazuara.

Në një gjendje të tillë të çështjes, kolegji ka gjetur se duhet bërë refuzimi i pretendimeve ankimore në ankesa dhe që të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.975/18 me datë 13.07.2021

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj